

VENDIM
Nr. 48, datë 7.3.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR PERIUDHËN 5-VJEÇARE (2018 - 2022)

Në mbështetje të neneve 16; 20, gjerat “a” dhe “e” dhe nenit 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 9 dhe 10 të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022),

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 808 prot., datë 15.1.2018, OSHEE sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022).
- Grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 14, datë 1.2.2018, të Kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga shoqëria OSHEE sh.a., duke konstatuar se plani i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5- vjeçare (2018 - 2022):
 - Paraqitet i ndarë sipas kategorive dhe zërave të shoqëruar me vlerat përkatëse financiare për investimet që priten të realizohen gjatë periudhës 5-vjeçare (2018-2022).
 - Përmirëson shërbimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes.
 - Bazuar në relacionin e dërguar nga OSHEE sh.a. do të ketë impakt në uljen e humbjeve teknike edhe joteknike.
 - Ndikon në mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuara dhe në Kodin e Shpërndarjes së energjisë elektrike.
 - Plotëson dhe përmirëson sistemin e matjes në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
 - Parashikon periudha kohore të zbatimit të investimit për ndërtimet apo rehabilitimet e investimeve përkatëse.
- Mbetet problematik zbatimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve, i cili duhet të shoqërohet me:
 - informacion të plotë lidhur me investimet e realizuara nëpërmjet partneritetit publik privat, kontratat dhe detyrim/realizimet;
 - informacion mbi financimin dhe burimin e këtyre financimeve për realizimin e planit të investimeve për periudhën 5-vjeçare (2018-2022), si dhe periudhat e shlyerjes së këtyre investimeve;
 - miratimin e Këshillit Mbikëqyrës për planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5- vjeçare (2018 - 2022).
- Në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE ka detyrimin të miratojë planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, për pesë vitet e ardhshme kalendarike, i cili përcillet në ERE për miratim, pas hartimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Planit e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 5-vjeçare (2018 - 2022)”.
2. OSHEE sh.a. të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin dhe informacionin e munguar sipas konstatimeve në këtë vendim.

3. OSHEE sh.a. duhet të paraqesë të përditësuar planin e investimeve konform nenit 75 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S

Erjola Sadushi